

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit E. K., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Z. K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.a. Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3365/2013 datë 7.7.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.11.2017, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3365/2013 datë 7.7.2017.

#### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3365/2013 datë 7.7.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 255/2008 datë 3.7.2013, me të cilin në pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a. në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material t'ia paguajë shumat si vijon: për dhimbje fizike shumë prej 5.000 €, për frikën e pësuar shumë prej 5.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 6.000 €, për zvogëlim të aftësisë punuese shumë prej 6.000 €, në emër të rehabilitimit klimatik shumë prej 750 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 400 €, në emër të ushqimit të përforcuar

shumën prej 600€, e në shumë të përgjithshme prej 23.750 €. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës t'i bart secila palë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose ato të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar, sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi është punëtor te e paditura në kohë të pacaktuar, në vendin e punës manipulante i konvejerit – .... Më datë 21.11.2007, rreth orës 6,30, në kohën kur ka përfunduar orarin e punës dhe është nisur për në shtëpi, duke kaluar nëpër shkallë të konvejerit ka rrëshqitur, me ç'rast ka pësuar përdredhje të zogut të këmbës së majtë e shoqëruar me thyerje shkolitëse të majës së zogut të jashtëm të nyjëtimin të shputës së djathtë.

Gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e provave të administruara, ka vlerësuar se në rastin konkret është provuar se dëmi ka lindur ngase paditësi nuk ka marrë veprimet e duhura konform detyrave të tij të punës, andaj e paditura nuk ka mund ta parasheh një gjë të tillë dhe në bazë të nenit 177 par.2 të LMD –ës, të paditurën e ka liruar nga përgjegjësia, ashtu që ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se paditësi me asnjë provë nuk ka mund të argumentojë se janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e të paditurës me rastin e lëndimit të tij në punë, pastaj ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët, nga gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë, drejt kanë konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Kjo nga fakti se eksperti i mbrojtjes në punë Dr. Hamid Nuredini ka konstatuar se në bazë të përshkrimit të vendit të punës, paditësi ka qenë personi përgjegjës dhe kryesor për manipulim të drejt, mirëmbajtjen e konvejerit me stabilimente dhe shiritin e gomës, dhe sipas këtyre detyrave të punës, paditësi ka pasur për obligim me njoftuar udhëheqësin e vet për gjendjen e shkallëve si dhe me kontaktuar me Shërbimin e mirëmbajtjes së makinerisë, ndërsa nëse ata nuk do të kishin marrë masa atëherë paditësi ka pasur të drejtë ta refuzojë punën dhe të njoftojë inspektoratin, veprime të cilat nuk i ka ndërmarrë paditësi.

Thëniet e revizionit të paditësit se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara, ngase, në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se në cilën pjesë apo ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara, ndërsa sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të bollshme dhe të qarta për një aktgjykim të drejtë e të bazuar në ligj, dispozitivi është i qartë dhe në harmoni me arsyetimin.

Pretendimi se aktgjykimi i kundërshtuar është kundërligjor dhe si i tillë i paqëndrueshëm sepse nuk ka shqyrtuar me kujdes ankesën dhe pretendimet nga ankesa, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësojë si të pabazuara, ngase aktgjykimi i cekur ka vlerësuar se qëndrimi juridik i i gjykatës së shkallës së parë është i drejt dhe i ligjshëm, se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale, ndërsa ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara sepse nuk kanë bazë në prova konkrete.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 177 par 2 të LPK-ës, ngase dëmi ka lindur nga veprimi i paditësit i cili nuk ka kryer detyrat e tij të punës për mirëmbajtjen e konvejerit, ndërsa e paditura nuk ka mundur të parashihte pasojat për t'i shmangur ato.

Kjo Gjykatë shton se, sipas parimit të përgjithshëm mbi bazën e përgjegjesisë neni 154 par. 1 i LMD, është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, ndërsa në rastin konkret nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës për shkaktimin e dëmit me rastin e lëndimit në punë të paditësit, andaj qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa pretendimet e cekura në revizion lidhur me përgjegjësin objektive për shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga fajësia, kjo Gjykatë i vlerësoi si të pabazuara.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 13.11.2014, Rev.nr.220/2017

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Kaçiku